



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.1029/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbarimore të kreditorit “B...”, SH.P.K, me seli në Rr. “...”, në Mitrovicë, kundër debitorit “K...”, SH.P.K, me seli në Rr. “/...”, ... në Prishtinë, duke vendosur sipas parashtrësës së kreditorit për tërheqjen e Urdhrit Përmbarimor P.nr 98/2021 të datës 21.05.2021 të Përmbaruesit Privat Ilmi Miftaraj, me seli në Mitrovicë, jashtë seancës me datën 26.10.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura e përmbarimit e lejuar sipas Urdhrit Përmbarimor P.nr. 98/2021 të datës 21.05.2021, të Përmbaruesit Privat Ilmi Miftaraj, në çështjen përmbarimore të kreditorit “B...”, SH.P.K kundër debitorit “K...”, SH.P.K, për shkak të tërheqjes së propozimit nga ana e kreditorit.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat Ilmi Miftaraj, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “B...”, SH.P.K, ka caktuar urdhrin P.nr 98/2021 me datën 21.05.2021, duke lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm: Faturës nr. 3 të datës 20.11.2020 me të cilin e ka urdhëruar debitorin “K...”, SH.P.K, që kreditorit ti paguaj shumën prej 85,538.22 € në emër të borxhit me kamatë prej 8%, në vit nga dita e ushtrimit të propozimit e deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit, me bllokimin e llogarisë bankare dhe regjistrimit, sekuestrimit, vlerësimit dhe shitjes së sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit me datë 05.07.2022 debitori ka paraqitur kërkesë për kthimin në gjendje të mëparshme dhe prapësim, ndërsa kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Përmbaruesi Privat Ilmi Miftaraj përmes akt përcjellësit të datës 01.04.2022 e ka njoftuar Gjykatën se kreditori me datën 30.03.2022 ka paraqitur kërkesë për tërheqjen e propozimit për përmbarim P.nr 98/21, duke ia bashkëngjitur aktit edhe kërkesën e kreditorit të datës 30.03.2022 me të cilën njoftohen organet kompetente përmbarimore, Përmbaruesi Privat dhe Gjykata, që kreditori bën tërheqjen e propozimit për përmbarim për shkak të arritjes së marrëveshjes mbi pagesën e borxhit me debitorin.

Gjykata duke u bazuar në dispozitën e nenit 42 par. 1 të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore i cili përcakton se “ *Propozimi për përmbarim mund të tërhiqet tërësisht apo pjesërisht nga kreditori gjatë zhvillimit të procedurës përmbarimore pa pëlqimin e debitorit*” dhe par. 2 të po këtij neni i cili përcakton se “ *Në rast të tërheqjes së propozimit për përmbarim organi përmbarues e përfundon përmbarimin në tërësi apo pjesërisht, varësisht nga ajo se a është tërhequr ai në tërësi apo vetëm pjesërisht* “, dhe duke vendosur sipas parashtrësës së kreditorit të datës 30.03.2022 këtë çështje përmbarimore e përfundoi në tërësi.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata konform nenit 42 të LPP-së, dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr 1029/22, datë 26.10.2022

Gjyqtarja

Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.